



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.406/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Zyhdi Haziri dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me ankesat e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Obiliq, Lulzim Bllaca nga radhët e subjektit politik PDK, me seli në Prishtinë, dega në Obiliq, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**HUDHEN** si të palejuara ankesat ZL.A.nr.406/2017, ZL.A.nr.407/2017, ZL.A.nr.408/2017, ZL.A.nr.409/2017, e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal të Obiliqit, Lulzim Bllaca nga radhët e subjektit politik PDK, me seli në Prishtinë, dega në Obiliq, të paraqitura me datën 23.10.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

### A r s y e t i m

Me datën 23.10.2017, PZAP-i ka pranuar 4 (katër) ankesa nga Lulzim Bllaca, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal të Obiliqit, nga radhët e subjektit politik PDK, me të cilat pretendon se i janë bërë gabime gjatë numërimit të votave, në Qendrat e Votimit të Komunës së Obiliqit, si në: Vendvotimi në Dardhishtë 151a/02D, 1519/01R; në Obiliq 1501/02R, 1501/01R.

Paneli, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartcekura dhe i trajton si një ankesë evidentuar me ZL.Anr.406/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për të dy ankesat i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës .

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

### **Ankesat janë të pa lejuara**


Paneli nuk është lëshuar fare vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesat e parashtruara përkitazi me manipulimin e votave në vendvotimet e cekura në ankesa, për faktin se shkeljet që ndërliken me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrihen pas shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj paneli vendosi që ti hedh si të parakohshme ankesat e ankueses. Hudhja e ankesave të ankueses nuk e paragjykon çështjen se ankueses i

mohohet e drejta që mbi këtë bazë, që të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
ZL. Anr.406/2017 më datën 24.10.2017.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Rafet Haxhaj**



**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*